

Njoftim për mbledhjen e tretë të Komisionit Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë

Referuar nenit 26 dhe 124 të nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc, ka thirrur mbledhjen e tretë të tij ditën e mërkurë, datë 27.09.2023, ora 16.00, pranë zyrave të Avokatit të Popullit.

Kjo mbledhje është thirrur me qëllim diskutimin e problematikave të hasura deri më tani sa i takon verifikimit të integritetit të kandidatëve, si dhe kohëzgjatjes së këtij procesi nga institucionet përgjegjëse.

Gjithashtu, gjatë mbledhjes do të miratohet versioni përfundimtar i rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc.